



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Çështjet Ligjore,
Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar

Tiranë më 11.07.2024

RAPORT

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR VITIN 2023**

I. Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjen e datës 14 Maj 2024, në zbatim të nenit 148/b shkronja (d), të Kushtetutës, nenit 38, pika 2, shkronja (d), e ligjit nr.97/2016 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe neneve 18, dhe 103 të Rregullores së Kuvendit, mori në shqyrtim “Raportin e Prokurorit të Përgjithshëm për Gjendjen e Kriminalitetit për Vitin 2023”.

Raporti vjetor, pasqyron të dhëna të detajuara, për numrin, llojet, shtrirjen territoriale, intensitetin, viktimat, kostot e kriminalitetit, format e kriminalitetit në vend, efektivitetin e ndjekjes penale, cilësinë e përfaqësimit të akuzës në gjyq, ekzekutimin e vendimeve penale dhe veprimtari të tjera thelbësore në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, përgjatë vitit 2023.

Përmbledhja e Raportit të Prokurorisë së Përgjithshme për Gjendjen e Kriminalitetit për vitin 2023, u prezantua nga Prokurori i Përgjithshëm Z. Olsian Çela.

II. Baza Ligjore

Në zbatim të nenit 148/b shkronja (d), të Kushtetutës, nenit 38, pika 2, shkronja (d), e ligjit nr.97/2016 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe

neneve 18, dhe 103 të Rregullores së Kuvendit, Prokurori i Përgjithshëm ka paraqitur “Raportin e Prokurorit të Përgjithshëm për Gjendjen e Kriminalitetit për Vitin 2023”.

Komisioni përgjegjës, bazuar në nenin 103, pika 3, të Rregullores së Kuvendit, organizoi seancën dëgjimore për shqyrtimin e raportit dhe në përfundim të diskutimeve hartoi një projekt-rezolutë të vlerësimit të punës së institucionit, të cilën ia paraqet seancës plenare.

Projektrezoluta përfshin vlerësime dhe konstatime lidhur me veprimtarinë e institucionit të pavarur, në rastin konkret të Prokurorit të Përgjithshëm për vitin 2023 si dhe rekomandime, të cilat institucioni i pavarur duhet t’i realizojë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, për vitin 2024.

III. *Diskutimi në Komision*

Gjatë diskutimeve në komision Z. Çela prezantoi raportit vjetor. Pas përfundimit të prezantimit të raportit vjetor, relatori e çështjes, i caktuar nga komisioni, Z. Klevis Xhoxhi parashtroi mendimin mbi raportin, dhe vlerësoi veprimtarinë e organit të prokurorisë gjatë vitit 2023. Z. Xhoxhi i drejtoi disa pyetje Prokurorit të Përgjithshëm lidhur me aspekte të veprimtarisë së tij.

Pas diskutimeve dhe pyetjeve të deputetëve, u konstatuan disa arritje dhe problematika të këtij institucioni.

U vlerësua angazhimi në procesin e zbatimit të hartës së re gjyqësore dhe në zbatimin e rekomandimeve të GRECO dhe përmbushjen e detyrimeve për realizimin e Planit të Veprimit ICRG/FATF. U diskutua mbi rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional. Si problematika parësore u evidentuan sërish krijimi i vakancave të përkohshme dhe të përhershme (deri në 38%) për shkak të rivlerësimit kalimtar të prokurorëve si dhe koordinimi me prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm. Rrijtja e numrit të kërkesave për inspektime tematike në bashkëpunim me ILD-në, ishte në vëmendjen e komisionit. Iu sugjerua Prokurorit të Përgjithshëm kryerja e një studimi tematik për të vlerësuar nëse ndryshimi i sistemit të vlerësimit ka ndikuar në uljen e performancës së prokurorëve nga sistemi i kaluar në sistemin aktual, si dhe t’i propozohen KLP-së indikatorë matës efektiv për punën e prokurorëve. Prokurori i Përgjithshëm u inkurajua të propozojë në Kuvend, ndërhyrjet e nevojshme, për të adresuar çështjen e sistemit të arkivës së prokurorisë. Gjithashtu u rekomandua aplikimi i masave alternative të sigurimit, që arresti me burg të jetë përjashtimi dhe jo rregulli.

Sa më sipër u sugjerua që të reflektohen në projektrezolutën që do miratohej nga Komisioni për vlerësimin e veprimtarisë për vitin 2024.

Në mbledhjen e datës 03 korrik 2024, Komisioni për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, mori në shqyrtim projektrezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2024”.

IV. Përfundime

Në përfundim të mbledhjes, Komisioni miratoi projektrezolutën me votat pro të shumicës së anëtarëve të pranishëm në mbledhje dhe ia paraqet për miratim seancës plenare, sipas variantit që i bashkëlidhet këtij raporti.

RELATOR

Klevis XHOXHI

KRYETARE

Klotilda BUSHKA



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

MIRATOHET

K R Y E T A R E

Lindita NIKOLLA

PROJEKTREZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË PROKURORISË SË PËRGJITHSHME PËR
VITIN 2023**

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

- Duke mbajtur në konsideratë rolin e prokurorisë në ushtrimin e ndjekjes penale, hetimin, përfaqësimin e akuzës në gjyq, ekzekutimin e vendimeve penale dhe kryerjen e detyrave të tjera të ngarkuara me ligj;
- Duke vlerësuar rëndësinë e raportimit të Prokurorit të Përgjithshëm në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit, zbatimin e rekomandimeve prioritare të Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit dhe për efektivitetin e ndjekjes penale;
- Duke vlerësuar rolin e Prokurorit të Përgjithshëm në nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme për prokurorët e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, për oficerët e Policisë Gjyqësore, si dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të tyre, si dhe kujdesjet për ushtrimin e kompetencave ligjore dhe kushtetuese të prokurorisë;
- Duke vlerësuar angazhimin në procesin e zbatimit të hartës së re gjyqësore, me synim garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit, me theks të veçantë tek e drejta e aksesit në drejtësi;

- Duke vlerësuar angazhimin për zbatimin e rekomandimeve të Grupit të Shteteve të Këshillit të Europës kundër Korrupsionit (GRECO) dhe përmbushjen e detyrimeve për realizimin e Planit të Veprimit ICRG/FATF;

Për veprimtarinë e Prokurorit të Përgjithshëm për vitin 2023 vlerëson se:

- Është rritur numri i procedimeve penale të filluara kryesisht;
- Është rritur cilësia e hetimeve për veprat penale të dhunës në familje dhe veprave penale ndaj të miturve. Ndaj të miturve në konflikt me ligjin është kujdesur të merren masa alternative dënimi si: shmangia, ndërmjetësimi, këshillimi për të miturin apo familjen dhe paralajmërimi me shkrim;
- Janë normuar masa administrative dhe procedurale për nxitjen e rolit aktiv dhe ushtrimin sistematik të kontrollit efektiv nga ana e prokurorëve dhe drejtuesve ndaj oficerëve të policisë gjyqësore në drejtim të ecurisë së hetimit të procedimeve;
- Është konsoliduar bashkëpunimi dhe koordinimi ndërinstytucional me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese palë në marrëveshje dy ose shumëpalëshe, me synim shtimin e burimeve dhe partnerëve për rritjen e cilësisë dhe efektivitetit në kryerjen e hetimeve në drejtimet prioritare të luftës kundër kriminalitetit;
- Është konsoliduar bashkëpunimi dhe koordinimi në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet gjyqësore të huaja nëpërmjet zyrës së Prokurorit Ndërlidhës të Shqipërisë në Eurojust, veçanërisht në rritjen e numrit të skuadrave të përbashkëta hetimore dhe goditjen e krimit;
- Është angazhuar në plotësimin e detyrimeve institucionale në zbatim të Planit të Veprimit të ICRG/FATF për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit duke e konsideruar si një objektiv të sajin prioritar, duke kontribuar që Shqipëria të dalë nga lista e juridiksioneve nën monitorim të shtuar, “lista gri”;
- Vijnë përparimet për të mundësuar zhvillimin e programit statistikor PRESTO për administrimin elektronik të regjistrave proceduralë dhe përfitimin e një sistemi statistikor fleksibël në kohë reale dhe me të dhëna gjithëpërfshirëse për periudhën tranzitore deri në ngritjen e sistemit të ri (CAMS);

Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2024, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet në këto drejtime:

1. Të rrisë numrin e hetimeve proaktive, përdorimin e teknikave të veçanta të hetimit dhe të zhvillojë përdorimin e teknikave të reja.

2. Të rritë numrin e kërkesave për inspektime tematike në bashkëpunim me ILD-në, për arritjen e standardeve të unifikuara në zbatimin e ligjit gjatë ushtrimit të funksionit, veçanërisht zbatimin e udhëzimeve me karakter të përgjithshëm për respektimin e garancive procedurale në procesin penal.
3. Të vijojë puna mbi marrjen e masave efektive për mbrojtjen e viktimave të veprave penale ndaj të miturve dhe veprave penale të dhunës në familje dhe të bashkëpunojë me institucionet shtetërore që ngarkohen me përgjegjësi për mbrojtjen e këtyre kategorive sipas legjislacionit në fuqi.
4. Të nxisë aplikimin e masave alternative të sigurimit (krahas masës së sigurimit, arrest me burg) duke përfshirë masat shtrënguese me karakter pasuror (garancia pasurore), për veprat penale dhe/ose autorët me rrezikshmëri të ulët shoqërore.
5. Të rritet angazhimi institucional në drejtim të zbulimit, gjurmueshmërisë dhe ndjekjes penale në rastet e krimit kibernetik dhe mashtrimin në internet, me fokus të miturit.
6. Të vijojë punën për ngritjen e sistemit të menaxhimit të çështjeve, si dhe ndërlidhjes duke bashkëpunuar me Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.
7. Të vijojë punën për zhvillimin dhe përfundimin e sistemit elektronik PRESTO për administrimin elektronik të regjistrave procedurale dhe përfitimin e statistikave.
8. Në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës si dhe partnerë të tjetër vendas dhe të huaj të nxiten e mbështeten trajnimet e prokurorëve dhe oficerëve të Policisë Gjyqsore sipas specializimit të tyre, me fokus të veçantë në krimin kibernetik, hetimin finaciari, dhunën në familje dhe atë me bazë gjinore.
9. Të plotësojë angazhimet institucionale që dalin nga rekomandimet e Këshillit të Ministrave apo raportet e organizmave të tjerë ndërkombëtarë të cilat kërkojnë një nivel më të lartë bashkëpunimit institucional mes drejtuesve të prokurorive në Prokuroritë e Shkallës së Parë dhe Apeleve me Prokurorinë e Përgjithshme.
10. Të vijojë angazhimin në sigurimin e aplikimit të uniformizuar të standardeve të hetimit dhe ndjekjes penale në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut, barazisë para ligjit dhe parimit të proporcionalitetit.
11. Të angazhohet në përmbushjen me efektivitet të detyrimeve institucionale në kuadër të raportimeve gjatë procesit të integritetit në Bashkimin Europian.

Miraturar në datën __.__.2024